




**Bashkia Tiranë**

**Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve**

**Spektori i Zhvillimit dhe Kujdesit Psiko-Social**

[www.femijetetiranes.al](http://www.femijetetiranes.al)



## **Programi i Edukimit në Çerdhe**

### **Muaji Korrik**

### **24 - 36 Muaj**

## Programi i Edukimit në Çerdhe, Muaji Korrik

Grupmosha: 24 - 36 muaj



Tiranë, 2022

Ky material, është vazhdimësi e materialeve, modeleve të përgatitura nga Sektori Psiko-Social, sipas muajve (tetor-korrik) në kuadër të hartimit dhe zbatimit të Programit të Edukimit në Çerdhet Publike, Bashkia Tiranë.

Ky material i shërben stafit edukator për përmirësimin e cilësisë së edukimit të fëmijëve në çerdhet publike të Bashkisë Tiranë, të grupmoshës 6 muajsh-3 vjeç, që frekuentojnë këto insitucione.

Programi përmban një larmi tematikash, aktiviteteve, lojërash sipas çdo jave duke i dhënë në këtë mënyrë hapësirën fëmijëve të gjejnë veten në të gjitha aktivitetet kreative brenda tij.

Programi është krijuar si model për të ndihmuar stafin edukator në kornizimin më mirë të rutinës në marrëdhënie me fëmijët.

Në zbatimin, realizimin e aktiviteteve, stafi edukator në marrëdhënie me fëmijët duhet të marrë në konsideratë kushtet atmosferike të muajit, temperaturat e larta, por dhe mungesat për shkak të pushimeve.

Stafi edukator të ndjehet i lirë të realizojë atë çfarë pëlqejnë fëmijët, duke u konsultuar me kolege dhe stafin mbështetës. Gjatë ditës mund të realizohen edhe aktivitete të tjera.

Punë të mbarë!

© Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret nga specialistë të tjerë të fushës, por jo për qëllime fitimi me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e DPÇK , Sektorit Psiko-Social si burim.

Programi i Edukimit për Stafin Edukator /24-36 muaj/ Muaji Korrik

Programi i Edukimit në Çerdhe, Muaji Korrik

Karakteristika të muajit.

Përshëndetje, të dashur fëmijë !

Përshëndetje edukatore !



Vera si të gjitha stinët e tjera ka tre muaj dhe Korriku është muaji i dytë i saj. Mendohet se Korriku është muaji më i nxehtë i vitit, për shkak të temperaturave të larta që e karakterizojnë.

Korriku është gjithashtu një muaj i begatë. Ai njihet si muaji i të korrave sepse piqen drithrat: gruri, misri, me të cilat bëhet mielli, buka, ëmbëlsirat, etj. Por në korrik, si në muajt e tjerë të verës ne shijojmë edhe plot fruta: pjeshka, kajsi, fiku, bostani etj.

Në korrik shumica e familjeve dhe fëmijëve ndjehen më të gëzuar, më të shplodhur pasi për një pjesë puna lihet pak mënjanë për të nisur pushimet verore pranë detit, liqenit, pishinave, malit, etj.

## Muaji Korrik

### Tema e Muajit: Pushimet Verore

#### Grupi: 24 - 36 muaj



**Java I:** Përgatitja për pushimet.

**Java II:** Lodrat, sendet, ngjyrat e pushimeve.

**Java III:** Ushqehemi shëndetshëm gjatë ditëve të nxehta të verës.

**Java IV:** Miqtë e verës.

#### Tema mujore: Pushimet Verore

Temat Javore	Qëllimi	Koha e realizimit
Përgatitja për pushimet.	Njohja me disa nga vendet ku mund të kalojmë pushimet e verës.	Java I
Lodrat, sendet, ngjyrat e pushimeve.	Njohja dhe nxitja e fëmijëve për të emërtuar lodrat, sendet, ngjyrat e tyre që përdorin kur shkojnë me pushime.	Java II
Ushqehemi shëndetshëm gjatë verës.	Ushqimet e shëndetshme dhe lëngjet që të freskojnë në verë.	Java III
Miqtë e verës	Përforcimi përmes tyre i njohjes së ngjyrave dhe numrave.	Java IV
Shënim: <ul style="list-style-type: none"><li>* Edukatorët duhet ta realizojnë sa më qartë shpjegimin dhe realizimin e aktiviteteve me qëllim përvetësimin sa më të thjeshtë të njohurive nga fëmijët.</li><li>* Stafit edukator duhet të informojë prindërit mbi tematikën mujore/javore për të siguruar bashkëpunimin e tyre. Diskutimi me fëmijët në shtëpi.</li></ul>		

Tema mujore: **Pushimet Verore**


Tema e javës: **Përgatitja për Pushime**  
**24 - 36 Muaj**

Java I - Ditët	Tema e ditës	Aktivitetet	Mjetet e punës
<b>E Hënë</b>	<b>Po nisin pushimet!!</b> 	<b>Bisedë:</b> Edukatorja bisedon, ju shpjegon fëmijëve se në verë ata bashkë me prindërit mund të shkojnë me pushime, pranë detit, në mal, në fshat, në pishina, në liqen, tek gjyshërit etj. <b>Vjersha:</b> “Deti”. <b>Loja:</b> “Me rërë dhe ujë”- improvizimi me lodra plazhi. <b>Lojë me muzikë:</b> Fëmijët kërcëjnë sipas ritmit muzikor.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Lodra të ndryshme plazhi
<b>E Martë</b>	<b>Pushimet pranë detit</b> 	<b>Bisedë:</b> Edukatorja bisedon, ju shpjegon fëmijëve rreth detit, ngjyrës blu, për peshqit, kripës që ka etj. <b>Elementët e plazhit:</b> Edukatorja u tregon fëmijëve lodrat, kova, komerdaret, krahëzat etj, (nëse ka në grup). <b>Vjersha:</b> “Deti”. <b>Aktivitet:</b> “Varka me ngjyra”. Përgatitja me letra me ngjyra, pipat për flamurin. Vendosja në një legen me ujë,(shiko modelin).	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Lodra plazhi Letra me ngjyra, pipa, kovë, legen, shishe kosi, qumështi, vinovil etj. 
<b>E Mërkurë</b>	<b>Pushimet pranë liqenit</b> 	<b>Bisedë:</b> Edukatorja ju shpjegon fëmijëve se shumë familje i kalojnë pushimet pranë liqenit. Uji i liqenit është i ëmbël. Pranë liqenit është më freskët, ka rërë dhe shpendë si: mjellma, pulëbardha, rosa, pata, peshq. <b>Kënga:</b> “Rosat lahen në liqen”. Imitimi i tingujve dhe lëvizjes së tyre. <b>Punim me plastelinë:</b> “Peshku”.(shiko modelin) <b>Loja:</b> “Birilat”.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Plastelinë, kopsa 

<b>E Enjte</b>	<b>Pushimet në mal/fshat</b> 	<b>Bisedë:</b> Edukatorja ju shpjegon fëmijëve rreth malit, ose fshatit. Ajrit të pastër, klimës së freskët, gjëlberimit në fusha, pemë, për kafshët, zogjtë e ndryshëm. <b>Vjersha:</b> “Pata qafëgjata”. <b>Loja:</b> “Imitimi i kafshëve”. Demonstrimi i tyre përmes lodrave. <b>Përralla:</b> “Loja elefanti”.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Lodra me kafshë të ndryshme Libri “365 rrëfenja para gjumit” (f.101).
<b>E Premte</b>	<b>Pushimet tek gjyshërit</b> 	<b>Bisedë:</b> Edukatorja ju shpjegon fëmijëve për kënaqësinë e pushimeve tek shtëpia e gjyshërve, gatimet e mira të gjyshes, shëtitjet së bashku. <b>Vjersha:</b> ”Gjyshja ime”. <b>Lojë:</b> Loja e telefonit – “Alo nëna do vij tek ti..”. <b>Vizatim ose Punë dore</b> (me forma gjeometrike): “Shtëpia e gjyshërve”.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Format A4, lapsa me ngjyra

Tema mujore: **Pushimet Verore**



Tema e javës: **Lodrat, sendet, ngjyrat e pushimeve.**

Java II - Ditët	Tema e ditës	Aktivitetet	Mjetet e punës
<b>E Hënë</b>	<b>Veshjet e plazhit</b> <b>Kapelja ime</b> 	<b>Bisedë:</b> Edukatorja ju shpjegon fëmijëve se kur shkojmë në plazh ne veshim rroba banjoje, me ngjyra, mbajmë syze, kapela, sandale, shapka. <b>Vjersha:</b> “Deti”. <b>Punë dore:</b> “Kapelja prej letre” me palosje. Edukatorja ndihmon fëmijët të krijojnë një kapele me palosje me letra me ngjyra. Emërtimi ngjyrave. <b>Lojra energjike:</b> ”Me karrige”.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Elementë plazhi, format A4, letra me ngjyra etj.
<b>E Martë</b>	<b>Lodrat e plazhit</b> 	<b>Bisedë:</b> Edukatorja ju tregon fëmijëve për lodrat: kova, lopata, topi, kamarderja, kalaja e rërës në breg etj. <b>Aktivitet:</b> “Një ditë në breg”. Emërtimi, numërimi i lodrave. <b>Vjersha:</b> “Deti”. <b>Ngjyrosje:</b> “Kamerdarja”, sipas modeleve të vizatuar nga edukatorja.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Lodra plazhi Format A4, lapsa me ngjyra
<b>E Mërkurë</b>	<b>Topi im</b> 	<b>Vjersha:</b> “Topi im”. <b>Loja:</b> “Topi në koshat me ngjyra”. Fëmijët hedhin topin sipas ngjyrës tek rrethi i vizatuar në dysHEME ose rrathë plastikë, (shiko modelin). <b>Vizatim/Ngjyrosje modeli:</b> “Topi i plazhit”.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Topa, shkumësa, rrathë 

<b>E Enjte</b>	<p><b>Libri, miku i pushimeve</b></p> 	<p><b>Vjersha:</b> “Librat rrinë radhë-radhë”.</p> <p><b>Lojë improvizuese:</b> “Në dyqanin e librave”. Fëmijët ndihmohen nga edukatorja. Numërimi, personazhet.</p> <p><b>Lojë energjike:</b> me lëvizje ritmike të udhëhequra nga edukatorja, etj.</p> <p><b>Përralla:</b> “Pinoku</p>	<p>Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Libra, revista Libri “365 rrëfenja para gjumit” (f.99).</p>
<b>E Premte</b>	<p><b>Me tren për pushime</b></p> 	<p><b>Lojë improvizuese:</b> Edukatorja ndihmon fëmijët në improvizimin e udhëtimit me tren. Përhëndesim, imitojmë etj. Vendosja në radhë si vagonat, numërimi.</p> <p><b>Vizatim ose Punë dore:</b> “Treni”, (fëmijët mund të ndahen në dy grupe). Vizatimi i modelit ose përgatitja përmes kutive, me letra me ngjyra. (shiko modelin)</p> <p><b>Loja:</b> “Treni”.</p> <p><b>Gjëegjëza:</b> “Treni”.</p> <p>Të gjithë rrotat i ka me hekur, dhe në hekur shpejt rrëshket, merr e çon me qindra vetë, nga qyteti në qytet.</p>	<p>Manuali i Lojrave Format A4, lapsa me ngjyra, kuti, letra me ngjyra etj.</p>

Tema mujore: **Pushimet Verore**


Tema e javës: **Ushqehemi shëndetshëm gjatë ditëve të nxehta të verës.  
24-36 Muaj**

Java III - Ditët	Tema e ditës	Aktivitetet	Mjetet e punës
<b>E Hënë</b>	<p><b>Uji dhe lëngjet e freskëta</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b>Edukatorja ju tregon fëmijëve për rëndësinë e ujit, lëngjeve të freskëta sidomos kur është shumë vapë. Frutat, perimet lahen me ujë të bollshëm. <b>Lojë:</b> “Shisheet dhe gotat tringëlluese”.(shiko modelin) Në disa gota, shishe, të hidhet sasi të ndryshme uji. Goditet lehtë me laps ose me lugë. Fëmijët dëgjojnë tinguj të ndryshëm për shkak të sasisë së ujit. Dallimi i tingujve. <b>Aktivitet:</b> “Përgatitja e lëngut ose sallatë frutash”-përdoren frutat në menun ditore të çerdhes.</p>	<p>Manuali i Lojrave Fruta, ujë me shkurë</p> 
<b>E Martë</b>	<p><b>Frutat e freskëta Pjeshka</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b>Edukatorja ju shpjegon, ju demonstroi fëmijëve përmes fotove, fruta të stinës si: pjeshka, kumbulla, kajsia etj. shija, forma. Nxiti fëmijët t’i emërtojnë dhe ti prekin ato. <b>Ngjyrosje modeli:</b> “Pjeshka”. <b>Lojë energjike:</b> “Me shami”.</p>	<p>Manuali i Lojrave Format A4, lapsa me ngjyra, letra me ngjyra etj.</p>
<b>E Mërkurë</b>	<p><b>Bostani</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b>Edukatorja ju tregon fëmijëve përmes fotove rreth bostanit, pjeprit, shijes së ëmbël, lëngut, ngjyra e kuqe, e verdhë. Nxiti emërtimin. <b>Punim me plastelinë ose vizatim:</b> “Shalqiri i kuq”.(shiko modelin) <b>Lojë energjike:</b> “Sylla -mbylla”.</p>	<p>Manuali i Lojrave Format A4, lapsa, letra me ngjyra, plastelinë etj.</p>

<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Akullorja</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b> Edukatorja pyet fëmijët për akulloren, shijen që ata pëlqejnë ps.sh. akullore me qumësht, çokollatë, fruta etj.  <b>Punëdore:</b> “Akullorja”.  Edukatorja vizaton përmes formave gjeometrike akulloren. Fëmijët ngjisin ose ngjyrosin format e krijuara më parë nga edukatorja. Shpjegohet forma, (shiko modelin).  <b>Loja:</b> “Çova një letër në postë”.</p>	<p>Manuali i Lojrave  Format A4, lapsa me ngjyra, letra me ngjyra etj.</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Drithërat  Luledielli, Gruri</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b>Edukatorja ju shpjegon fëmijëve se në verë dielli shkëlqen më shumë. Luledielli dhe kallëzat e grurit janë të verdha si rrezet(ilustrimi me foto).  <b>Vjersha:</b> “Dielli”.  <b>Punëdore:</b> “Luledielli”.  Edukatorja ndihmon fëmijët të krijojnë lulediellin duke përdorur letra me ngjyrë të verdhë, pipa plastike, (shiko modelin).  <b>Përrallë:</b> “Të korrrat”.  <b>Gjëgjëza:</b> “Luledielli”.  Rrumbullake, si dielli jam, emrin nga ai e kam.  dhe e bukur, dhe me vlerë, arat zbukuroj në verë.</p>	<p>Manuali i Vjershave  Revista  Letra, lapsa me ngjyra, pipa etj.  Libri “365 rrëfenja para gjumit” (f.114).</p>

Tema mujore: **Pushimet Verore**

Tema e javës: **Miqtë e verës**

Java IV - Ditët	Tema e ditës	Aktivitetet	Mjetet e punës
E Hënë	<b>Bleta punëtore</b> 	<b>Bisedë:</b> Edukatorja ju flet fëmijëve për bletën, sa punëtore është, ajo shëtit nëpër lule. Nga bleta marrim mjaltin me të cilin përgatisim ëmbëlsira. <b>Vjersha:</b> “Bleta”. <b>Aktivitet:</b> “Krijimi i bletës”- edukatorja ndihmon fëmijët në ngjitjen e pjesëve. Prerja, ngjitja me letra me ngjyra, (shiko modelin). <b>Loja:</b> “Vigani, shkurtabiqi”. <b>Përrallë:</b> “Një llupës i madh”.	Manuali i Vjershave Manuali i Lojrave Letra me ngjyra, tuba letre, vinovil etj. Libri:“365 rrëfenja para gjumit”(f.128).
E Martë	<b>Nusepashka</b> 	<b>Punë dore:</b> “Nusepashka”. Edukatorja së bashku me fëmijët krijojnë nusepashkën përmes pjatave plastike duke e ndarë pjatën përgjysmë dhe lyerjen me bojë ose bojra uji. Emërtimi i ngjyrave, (shiko modelin). Edukatorja ju tregon fëmijëve për nusepashkën si lëviz në lule, si e mbajmë në dorë. <b>Lojë energjike:</b> ” Tërheqje litari, Kërcimi në vend”. <b>Përrallë:</b> ”Fluturimi i parë”.	Letra me ngjyrë të kuqe, patate etj. Libri:“365 rrëfenja para gjumit”(f.128). 
E Mërkurë	<b>Flutura</b> 	<b>Bisedë:</b> Edukatorja ju shpjegon fëmijëve për fluturën, sa e bukur është, krahët saj, shëtitja nëpër lule. <b>Vjershë:</b> “Flutura”. <b>Ngjyrosje modeli:</b> “Flutura”. krijimi me duar dhe gishtat e fëmijëve, ose me forma. Emërtimi i ngjyrave. (shiko modelin) <b>Gjëgjëza:</b> “Flutura”. Ka dy krahë ngjyra-ngjyra, që ngjason me një pikturë fluturon lule më lule, veçse mjaltin se bën kurrë.	Manuali i Vjershave Format A4, lapsa, bojra me ngjyra 

<p><b>E Enjte</b></p>	<p><b>Zogjtë</b></p> 	<p><b>Bisedë:</b>Edukatorja ju shpjegon fëmijëve rreth zogjve, cicërimat, fluturimi i tyre.  <b>Vjersha:</b> “Zogu i vogël”.  <b>Punëdore:</b>“Zogu”.          Ndhimohen fëmijët në ngjitjen e pjesëve. Prerja, ngjitja me letra me ngjyra, pjata plastike. (shiko modelin)  <b>Lojë improvizuese:</b>“Rrahim krahët si zogu”.</p>	<p>Manuali i Vjershave          Manuali i Lojrave          Letra me ngjyra, pjata plastike, ngjitës etj.</p> 
<p><b>E Premte</b></p>	<p><b>Kërmilli</b></p> 	<p><b>Punë me plastelinë:</b> “Kërmilli”.          Ilustrimi nga modeli në foto. Ndhimoni fëmijët të prekin, shtypin me gishta.          Edukatorja ju tregon fëmijëve për kërmillin, ngadalësinë tij, guaskën etj.  <b>Përrallë:</b> ”Kërcimi i kërmillit”.  <b>Lojë fizike:</b> “Ecja drejt”.</p>	<p>Manuali i Lojrave          Letra me ngjyra, plastelinë, lapsa, ngjitës etj.          Libri: “365 rrëfenja para gjumit(f.99).</p> 